



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 376/prot.
5

Tiranë më 16.4.2018

REKOMANDIM

Nr. 15, datë 16.4.2018

MBI

ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 a/1, dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "ABCOM" sh.p.k.

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 85, datë 06.03.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "ABCOM" sh.p.k me objekt:

- Verifikimi i ankesës të paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga një qytetar në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale, në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Hetimi pranë këtij kontrolluesi u iniciua mbi bazën e ankesës së paraqitur nga personi me iniciale M.V, që pretendonte se kontrolluesi "ABCOM" sh.p.k kishte përhapur të dhënat personale, pa informimin paraprak të tij/saj, në adresë të kompanisë "D & A Fin Partner" sh.p.k. Ky hetim u vlerësua si mjaft i rëndësishëm për shkak të specifikave që paraqet mënyra e përpunimit të të dhënave personale në kuadër të praktikës së delegimit të shërbimit të rikuperimit të detyrimeve financiare dhe interesit publik që paraqet mbrojtja e të dhënave personale në këtë fushë.

Kontrolluesi "ABCOM" sh.p.k ka si objekt të veprimtarisë tregëtare atë të ofrimit të shërbimeve në fushën e telekomunikacionit duke ofruar shërbime interneti, telefonie dhe televizioni. Gjatë ofrimit të shërbimeve përpunon të dhëna personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave "Klientë" (edhe debitorë), manualisht dhe në format elektronik.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi, Zyra e Komisionerit konstatoi se:

1. "ABCOM" sh.p.k (në cilësinë e kontrolluesit), nëpërmjet "kontratës së shërbimit për rikuperimin e detyrimeve financiare me palë kreditore", ka autorizuar dhe i ka deleguar shoqërisë "D & A Fin Partner" sh.p.k (në cilësinë e përpunuesit) shërbimin e rikuperimit të detyrimeve financiare të debitorëve të saj. Në kuadër të kësaj kontrate kontrolluesi i ka transmetuar përpunuesit të dhënat e debitorëve. Pjesë e këtyre debitorëve është edhe pala ankuese, e cila është kontaktuar nga përfaqësuesit e kësaj shoqërie dhe i është bërë me dije detyrimi kontraktor.

2. Në "Kontratën e Pajtitimit për ofrimin e shërbimit të komunikimeve elektronike dhe televizionit dixhital kabllor" dhe "Formularin e regjistrimit për përdoruesit e shërbimit të aksesit në internet në rrjete fikse", nënshkruar nga ankuesi dhe kontrolluesi "ABCOM" sh.p.k nuk parashikohen dispozita mbi informimin e subjektit të të dhënave personale (klientit, debitorit), mbi kategoritë e të dhënave personale, qëllimin dhe mënyrën e përpunimit dhe transmetimit të të dhënave personale të marrësi "D & A Fin Partner" sh.p.k, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, dhe masat e sigurisë, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Gjithashtu, nga verifikimi i kryer në faqen online të kontrolluesit www.abcom.al, rezultoi të mos jetë publikuar rubrika mbi "Politikat e privatësisë" të kontrolluesit, duke mos u dhënë mundësi subjekteve të të dhënave të informohen mbi mundësinë e përhapjes/transmetimit të të dhënave të tyre personale (qëllimin dhe bazën ligjore përkatëse), afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë dhe ushtrimit të të drejtave të tyre, në kundërshtim me nenin 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Detyrimi për informim qëndron ndaj kontrolluesit "ABCOM" sh.p.k pasi ky i fundit i ka mbledhur të dhënat personale të klientëve për qëllime të ofrimit të shërbimit ndaj tyre dhe nëpërmjet kontratës me "D & A Fin Partner" sh.p.k i transmeton/përhap të dhënat për një qëllim tjetër (mbledhja e detyrimeve financiare). Në frymën e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, kontrolluesi ka detyrin që të përpunojë të dhënat personale në përputhje me qëllimin e grumbullimit (neni 5/1/b) dhe në momentin që qëllimi ndryshon së paku ka detyrimin që të njoftojë subjektin e të dhënave, në të kundërt përpunimi i mëtejshëm i të dhënave do të konsiderohej i paligjshëm. Detyrimi për informim në rastet e përpunimit/përhapjes/transmetimit të të dhënave personale nuk mund të delegohet në asnjë lloj forme dhe duhet trajtuar vetëm në frymën e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

3. Në kuadër të zbatimit të nenit 21 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, nga verifikimi i njoftimit të kontrolluesit “ABCOM” sh.p.k, rezultoi se nuk është përditësuar përmbajtja e tij sa i përket emrit të personit të kontaktit, kategorive të tjera të subjekteve të të dhënave (punonjës), qëllimit të përpunimit dhe nuk është reflektuar në rubrikën 7 “Marrësit e të dhënave personale” përhapja dhe transmetimi i të dhënave të klientëve debitorë në kuadër të kontratës së nënshkruar midis kontrolluesit dhe kompanisë “D & A Fin Partner” sh.p.k.

Zyra e Komisionerit vlerëson se detyrimi për të përditësuar njoftimin nëpërmjet “Formularit të Njoftimit” është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin e të dhënave që kryen kontrolluesi dhe të ushtrojnë në mënyrë korrekte të drejtat që u jep ligji.

Në vijim Zyra e Komisionerit vlerëson angazhimin e shpejtë të kontrolluesit për plotësimin e përditësimit të “Formularit të Njoftimit” duke përmbushur detyrimin ligjor përkatës (shkresa nr. 635 prot, datë 10.04.2018, depozituar nga kontrolluesi).

4. Kontrolluesi nuk kishte hartuar një “Rregullore specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, por dispononte disa dokumente të brendshme që parashikojnë masa dhe procedura organizative që nuk janë gjithëpërfshirëse pasi nuk përfshijnë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale të kontrolluesit për çdo kategori subjektësh të të dhënave, sipas parashikimeve në nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një “Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, e detyrueshme për çdo punonjës të kontrolluesit, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjekti të dhënash), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj, konsiderohet një detyrim mjaft i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, pasi shmanj pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave. Kjo rregullore duhet të jetë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale të kontrolluesit për çdo kategori subjektësh të të dhënave, sipas deklarimeve në “Formularin e Njoftimit”.

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin e hetimit administrativ. Lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ përfaqësuesit e kontrolluesit parashtruan se kanë vlerësim të ndryshëm me konstatimet e këtij procesverbali, dhe paraqitën pretendimet si më poshtë:

- “ABCOM” sh.p.k ka respektuar parashikimet e nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. i ndryshuar. Ndaj kontrolluesit aplikohen rastet përjashtimore nga detyrimi për njoftim referuar nenit 18/3 shkronja b dhe ç .

“Kontrolluesi nuk është i detyruar të japë informacion dhe të informojë për rastet kur të dhënat personale nuk janë marrë nga subjekti i të dhënave. nëse:

b) ai detyrohet të kryejë përpunimin e të dhënave personale në bazë të një parashikimi ligjor;

c) ai përpunon të dhëna personale, të marra me pëlqimin e subjektit të të dhënave”.

- Lidhur me rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale kërkohet detajim të konstatimeve dhe ka paqartësi mbi përmbajtjen e saj.
- Sa i përket “politikave të privatësisë”, bëhet referim në faqen e “ABCOM” sh.p.k, në rubrikat për pajtimtarin.

Lidhur me pretendimet e paraqitura me shkrim nga kontrolluesi mbi konstatimet e evidentuara nga grupi i inspektimit në procesverbalin e hetimit administrativ, Zyra e Komisionerit vlerëson se rastet përjashtimore nga detyrimi për informim, parashikuar në nenin 18/3, i referohen vetëm rasteve “kur të dhënat **nuk** janë marrë nga subjekti i të dhënave personale”. Sa i përket kontrolluesit, Zyra e Komisionerit vlerëson se të dhënat personale të klientëve (në cilësinë e subjekteve të të dhënave personale) janë marrë drejtpërdrejtë prej tyre dhe me pëlqimin e tyre të lirë, në momentin e nënshkrimit të kontratës së shërbimit (Kontrata e Pajtimit për ofrimin e shërbimit të komunikimeve elektronike dhe televizionit dixhital kabllor). Në këtë kuadër pretendimi për përjashtim nga detyrimi për informim nuk është i mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Gjithashtu, informimi në kushtet e përhapjes/transmetimit të të dhënave është shumë i rëndësishëm dhe nuk i nënshtrohet në asnjë rast përjashtimeve të parashikuara në nenin 18/3 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Kjo nënkupton që informimi i subjekteve të të dhënave personale (klientëve) në rastet e përhapjes/transmetimit të të dhënave të tyre personale merr vlerën e “*condicio sine qua non*”, pra një kusht pa të cilin nuk legjitimohet kjo veprimtari përpunuese.

Sa i përket pretendimeve lidhur me paqartësitë në hartimin e më pas miratimin e një “Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale” dhe përmbajtjen e saj, Zyra e Komisionerit rithekson se aktet e brendshme janë të kufizuara në përmbajtje dhe nuk reflektojnë detyrimet ligjore sipas kategorive specifike të të dhënave personale që përpunon kontrolluesi dhe kategorive të subjekteve të të dhënave (deklaruar në Formularin e Njoftimit), në referim të parimeve ligjore dhe rregullave specifike të parashikuara në udhëzimet specifike të miratuara nga Zyra e Komisionerit. Parashikimet në rregullore ndryshojnë nga kontrolluesi në kontrollues, në varësi të fushës së veprimtarisë, mjeteve dhe mënyrës së përpunimit, kategorisë së të dhënave dhe subjekteve të të dhënave personale, etj. Në këtë kuadër është detyrim i çdo kontrolluesi që të analizojë elementët e veprimtarisë përpunuese dhe të hartojë dhe miratojë rregulloren e brendshme në frymën e parashikimeve ligjore.

Sa i përket “politikave të privatësisë”, Zyra e Komisionerit vlerëson se duhet të hartohet një rubrikë specifike që të përmbajë të gjithë elementët e detyrimit për informim parashikuar në nenin 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave

Personale”, i ndryshuar dhe në referim të Opinionit të Zyrës së Komisionerit “Mbi mbrojtjen e të dhënave personale në faqet e internetit të kontrolluesve publik dhe privat”.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 18, 21, 22, 27, 29, 30 dhe 31/1, gërma a/1 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi “ABCOM” sh.p.k. në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të marrë masa për informimin e subjekteve të të dhënave personale (klientët, debitorë, etj), mbi qëllimin dhe mënyrën e përhapjes/transmetimit të të dhënave personale te marrësit, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, dhe masat e sigurisë; Të publikohet në faqen zyrtare në internet rubrika mbi “Politikat e Privatësisë”, në referim të Opinionit të Zyrës së Komisionerit “Mbi mbrojtjen e të dhënave personale në faqet e internetit të kontrolluesve publik dhe privat” (publikuar në faqen zyrtare www.idp.al).
2. Kontrolluesi “ABCOM” sh.p.k. në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e “Formularit të Njohimit”, për të gjitha ndryshimet e mundshme në përpunimin e të dhënave personale në vazhdimësinë e aktivitetit të tij.
3. Kontrolluesi “ABCOM” sh.p.k. në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të hartojë dhe miratojë një “Rregullore specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, që të jetë e detyrueshme për çdo punonjës të kontrolluesit, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjekti të dhënash), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj.
4. Përbushjen nga ana e kontrolluesit “ABCOM” sh.p.k. të detyrimeve të parashikuara në pikat 1 dhe 3, brenda një afati 30 (tridhjetë) ditor nga momenti i marrjes dijeni.
5. Në rast mos përbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 16. 4 .2018.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi